

E ENJTE 24 MARS 2022

Nuk është hera e parë, në fakt, që opozita kritikon një paketë sapo del. Kështu ka bërë me 2 paketat që nxorëm për të përballuar vështirësitë pas fatkeqësive të tërmetit dhe të pandemisë, kështu po bën edhe kësaj radhe, nuk është çudi. Ajo që më çudit sot është se shumica e personave që flasin në këtë foltore dhe kritikojnë nuk e kanë lexuar një pjesë të mirë të paketës, sepse shumë nga grupet për të cilat ju kërkon mbështetje janë adresuar, ku transparenca është gjithashtu e adresuar. Është shumë e lehtë të nxjerrësh fatura të tregjeve në Angli, mund të merrni edhe të Gjermanisë, mund të merrni edhe të Greqisë, ku çmimet ndoshta duhet të jenë kokëforte dhe duhet të kundërshtojnë atë që sapo thatë pak më parë, megjithatë e rëndësishme është sesi ne të mbështesim qytetarët në një moment të vështirë, në një përballim krize, që në fakt është e treta për nga radha në një kohë kaq të shkurtër, me të cilin duhet të përballen familjet shqiptare, por edhe buxheti i shtetit.

Opozita do të bënte mirë të mos kritikonte, por të jepte teoritë e saj ekonomike. Ka mjaftueshëm ekonomistë këtu që mund të sjellin edhe një mbështetje për qeverinë, por nuk bën këtë gjë, bën vetëm kritika dhe flet me pankarta kundër çdo mbështetjeje që bën qeveria për shtresat në nevojë në mënyrë të veçantë. Dua t'i kthehem përsëri paketës, sepse është e nevojshme për të sjellë në vëmendjen e të gjithë qytetarëve çfarë ka sjellë dhe kë mbështet ajo paketë. Së pari, flasim për pensionistët. Janë një numër i konsiderueshëm personash, të cilët sot, me indeksimin e çmimit, marrin një shumë më të lartë se ajo që do të merrnin në momentin e zbatimit të indeksimit, sipas vendimit të fundvitit, ku janë 10 milionë dollarë më shumë sesa ishin parashikuar. Së dyti, flasim për fermerët, të cilët marrin, si një politikë në vijim, më shumë para për kompensimin e naftës pa taksa. Së treti, flasim për të gjithë personat, që kanë kompensim të asaj që është tarifë e shtuar, si rezultat i kësaj situatë për transportin urban dhe ndërqytetës. Së katërti, flasim për të gjithë individët, gati 450 mijë individë, të cilët marrin një bonus për 3 muaj me një vlerë 9 mijë lekë dhe, mbi të gjitha, harrojmë që çmimi i energjisë nuk është rritur, këtu flasim për të gjithë shqiptarët, për të gjitha bizneset, të cilët në një situatë tjetër do të kishin një faturë shumë më të lartë në llogarinë e tyre familjare.

Të vihet me recetën e vetme për të ulur taksat, kjo do të thotë që nuk ka një ndërgjegjësim se çfarë është e ardhura në buxhet të shtetit dhe sesi kjo e ardhur duhet të jetë e forcuar jo vetëm për sot, jo vetëm për këtë krizë, por në vijueshmëri. Shteti shqiptar mbështetet te këto të ardhura, por ditën që këto të ardhura i vë në përdorim dhe shfrytëzim, duke realizuar akte normative në kohë optimale për të mbështetur shtresat në nevojë, duhet duartrokatur të paktën nga ju të rinjtë, nëse duhet kritikuar, duhet bërë me teza dhe propozime konkrete, as për të shkuarën e shumë vjetëve më përpara, por për atë që është perspektiva e përbashkët për shqiptarët, që është një ofertë e mirë për të gjithë ata që votojnë majtas dhe djathtas, përtej kritikave, por me zgjidhje konkrete. Le ta lemë qeverinë të bëjë punën e saj dhe të vijë në mbështetje si të transparencës, por mbi të gjitha të individëve, që kanë më shumë nevojë për të. Faleminderit!